



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

DEKRET
PËR
KTHIMIN E LIGJIT NR. 9720, DATË 23.04.2007
“PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK”.

Në mbështetje të neneve 85 dhe 93 të Kushtetutës

Dekretoj

Kthimin për rishqyrtim edhe njëherë në Kuvend të ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Nr. Dekretit 5315
Tiranë, më 15.05.2007

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
ALFRED MOISIU





Republika e Shqipërisë
Presidenti i Republikës

Motivimi i kthimit të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

Të nderuar deputetë,

Në datë 27.04.2007 më ka ardhur për shpallje ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” të cilin, në bazë të nenit 85, paragrafi 1, të Kushtetutës, vendosa të mos e shpall, dhe ta kthej edhe njëherë për rishqyrtim.

Një qeverisje demokratike dhe në shërbim të interesave të qytetarëve bazohet jo vetëm në zbatimin e drejtë të Kushtetutës dhe ligjeve, por, edhe në ushtrimin me përgjegjshmëri dhe transparencë të funksioneve të saj. Transparenca në veprimtarinë e përditshme të zyrtarëve publike është padyshim një nga elementët dhe kërkesat që kërkon një qeverisje kushtetuese. Më e rëndësishme bëhet kërkesa për transparencë kur shtrohet për diskutim veprimtaria ekonomike e institucioneve shtetërore. Kontrolli apo auditimi i kësaj veprimtarie, i menaxhimit dhe i përdorimit të fondeve publike dhe i tërë veprimtarisë financiare të institucioneve të sektorit publik është një detyrim ligjor dhe politik thelbësor në një shtet të së drejtës.

Kushtetuta e Shqipërisë, ashtu si edhe shumë kushtetuta të tjera të bazuara, në parime demokratike të qeverisjes, ia ka ngarkuar rolin dhe funksionin e kontrollit të veprimtarisë ekonomike të sektorit publik, institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kushtetuta, në nenin 162 të saj përcakton se “Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës”. Ky pozicion kushtetues i KLSH lidhet ngushtë me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Është pikërisht, ky parim i rëndësishëm qeverisjeje, që kërkon që kontrolli i veprimtarisë së organeve publike, të bëhet jo nga një degë e pushtetit, cilado

pushtetet, legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Pra, një institucion i tillë, është një hallkë ndërmjet tre pushteteve, por, në varësi të Kushtetutës dhe ligjeve, dhe jo të një pushteti të veçantë. Një pozicion i tillë i Kontrollit të Lartë të Shtetit do të garantonte pavarësinë e këtij institucioni, do të siguronte zbatimin me paanësi të funksioneve të tij, pa asnjë ndikim nga pushteti legjislativ, ekzekutiv, apo gjyqësor. Për këtë arsye, Kushtetuta ka përcaktuar kritere dhe standarte të qarta për emërimin dhe shkarkimin e Kryetarit të KLSH, duke ia ngarkuar këtë zgjedhje, Kryetarit të Shtetit dhe Kuvendit. Po ashtu, Kushtetuta, për të garantuar funksionimin e pavarur të këtij organizmi që kontrollon përdorimin e fondeve buxhetore, ka rregulluar në një kre më vehte, fushën e veprimtarisë së tij, raportin me Kuvendin dhe imunitetin e titullarit të institucionit.

Edhe ligjin e ardhur për shpallje e kam vlerësuar në këtë prizëm kushtetues dhe politik. Nga analiza e këtij ligji, më rezulton se cenohet pikërisht, fryma që Kushtetuta përçon në rastin e kontrollit të veprimtarisë ekonomike të sektorit publik.

Së pari, çmoj se neni 2 i ligjit bën një dublim të rolit kushtetues të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pasi, fusha e zbatimit të auditimit të brendshëm sipas ligjit të ardhur për shpallje është e njëjtë me funksionet që i ngarkohen KLSH nga Kushtetuta dhe ligji organik i tij, i cili miratohet me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Nenet 162 dhe 163 të Kushtetutës dhe nenet 1 dhe 7 të ligjit nr 8270, datë 23.12.1997 “Për KLSH”, i ndryshuar, kanë përcaktuar qartësisht pozicionin dhe rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në sistemin qeverisës në Shqipëri. Dublimi që parashikon ligji i ardhur për shpallje do të ishte i panevojshëm dhe krijon dublim kompetencash mes KLSH dhe auditimit të brendshëm.

Së dyti, dhënia e kompetencës për auditimin dhe kontrollin e institucioneve të pavarura apo organizmave që nuk janë në varësi të pushtetit ekzekutiv, një organi në varësi të pushtetit ekzekutiv, më konkretisht, Ministrit të Financave, padyshim do të vinte në kundërshtim me sistemin politik të qeverisjes në shtetin e së drejtës. Pavarësisht, se neni 5 i ligjit përcakton parimet e ligjshmërisë, pavarësisë, paanësisë dhe fshehtësisë, si parime të përgjithshme të funksionimit të auditimit, fusha e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, organizimi dhe varësia e tij, nuk garantojnë pavarësi dhe paanësi të kësaj njësie.

Së treti, fusha e zbatimit të auditimit të brendshëm parashikuar në nenin 2 të ligjit për bërënia e auditimit të brendshëm të përcaktuar në nenin 5, varësi

dhe kompetencat e drejtorisë së përgjithshme të auditimit, përcaktuar në nenet 15 dhe 16, detyrimi i institucioneve të pavarura për të siguruar realizimin e auditimit të brendshëm, përcaktuar në nenin 25, janë dispozitat, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë çenojnë parimin e ndarjes së pushteteve të parashikuar nga neni 6 i Kushtetutës. Asnjë pushtet nuk mund të imponojë vullnetet e tij mbi pushtetet e tjera. Pushteti ekzekutiv nuk mund të detyrojë institucionet, jo në varësi të tij, të sigurojnë realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, pasi këtë funksion Kushtetuta ia ka dhënë një institucioni të pavarur, siç është KLSH, pikërisht, për të ruajtur pavarësinë e pushteteve. Ndërsa, vetë institucionet e pavarura kanë auditimin e tyre të brendshëm.

Se katërti, neni 26 i ligjit barazon Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit me Kontrollin e Lartë të Shtetit, kur, kërkon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit mes këtyre dy institucioneve. Kjo vjen në kundërshtim me nenet 162, 163 dhe 164 të Kushtetutës. Kushtetuta ka përcaktuar se KLSH është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, fushën e veprimtarisë së tij, dhe se është Kuvendi organi ku KLSH paraqet raportin, mendimet dhe informacionet që disponon.

Të nderuar deputetë,

Mendoj se ligji nuk ka problem vetëm të rregullimit të disa dispozitave. Ai, për shkak së është ngritur mbi një koncept jo kushtetues, duhet riparë në kuptimin substancial dhe jo formal duke rregulluar disa nene të tij. Në këto kushte, mendoj se duhet rishqyrtuar dhe duhet riformuluar duke u bazuar mbi një filozofi të ndryshme nga ajo mbi të cilën ngrihet ligji i ardhur për shpallje, pasi unë mendoj se, forcimi i kontrollit të brendshëm për verifikimin e përdorimit të fondeve buxhetore është shumë i rëndësishëm dhe parandalues ndaj fenomeneve abusive. Në të njëjtën kohë, ai do të ishte një ndihmë edhe për vetë ushtrimin e funksioneve kushtetuese të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Duke ju falenderuar paraprakisht për mirëkuptimin tuaj,

Me respekt,

Alfred Moisiu



President i Republikës.